



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 217, Datë 11.10.2018

MBI

**KËRKESËN E SHOQËRISË “DANSKE COMMODITIES ALBANIA” SH.P.K PËR
DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ANA E ERE-S, PËR NDRYSHIMIN E ORTAKUT
TË VETËM TË SHOQËRISË “DANSKE COMMODITIES A/S”, ME 100% TË
KUOTAVE TË KAPITALIT, NËPËRMJET SHITJES**

Në mbështetje të nenit 16 të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar; pikës 5.2 të “Licencës së veprimtarisë së tregtimit të energjisë elektrike” dhe pikës 9.2 të “Licencës së veprimtarisë së Furnizimit të energjisë elektrike”, si dhe nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Proçedurave të ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.10.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi kërkesën e shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., për dhënie e autorizimit nga ana e ERE-s, për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë “Danske Commodities A/S”, me 100% të kuotave të kapitalit, nëpërmjet shitjes,

Konstatoi se:

- Shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 601 Prot, datë 24.09.2018, ka përcjellë kërkesën për dhënie e autorizimit nga ana e ERE-s në lidhje me ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë “Danske Commodities A/S”, me 100% të kuotave të kapitalit, nëpërmjet shitjes.
- Në këtë kërkesë shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k., bën me dije ERE-n se ndodhet në fazën e ndryshimit të ortakut të vetëm të saj.
- Shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k., zotërohet 100% nga shoqëria “Danske Commodities A/S”, e regjistruar në përputhje me legjislacionin e Danimarkës, me nr. 28113951 regjistrimi, me seli qendrore në Aarhus Danimarkë.
- Sa më sipër shoqëria “Danske Commodities Albania” sh.p.k., bën me dije ERE-n se, kanë filluar procedurat për blerjen e Ortakut “Danske Commodities A/S”, nga shoqëria norvegjeze multinacionale “Equinor” e cila operon në sektorin energjitik dhe atë të gazit natyror. Aktualisht procesi i blerjes është në pritje të aprovimit nga Komisioni European, si dhe nga autoritetet përkatëse të konkurrencës dhe finalizimi i tij pritet në fund të vitit.
- Shoqëria sjell në vëmendje se “Danske Commodities A.S” ose Ortaku, do të vazhdojë të drejtohet nga i njëjti ekip menaxhues dhe do të vazhdojë të ketë selinë e saj në Aarhus Danimarkë. Pas blerjes për një periudhë fillestare “Danske Commodities A.S”

do të vazhdojë të operojë në një mënyrë të pavarur, duke ruajtur të pandryshuar emrin dhe markën e saj.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Dhënien e autorizimit për ndryshimin e ortakut të vetëm të shoqërisë “Danske Commodities A/S”, me 100% të kuotave të kapitalit, nëpërmjet blerjes nga shoqëria norvegjeze “Equinor” .
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI